



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Dakovica
Municipality of Gjakova
Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale



Nr.005 /2026

Datë:02/03/2026.

FTESË PUBLIKE PËR APLIKIM

(për Aplikim për Mbështetje Financiare për Mjekim)

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Gjakovës njofton qytetarët e Komunës së Gjakovës se është hapur thirrja publike për aplikim për subvencione dhe mbështetje financiare shtesë për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit mjekësor për personat që vuajnë nga sëmundje kardiovaskulare, sëmundje kancerogjene si dhe sëmundje të tjera kronike.

Qëllimi i kësaj ftese publike është mbështetja e pacientëve me nevoja të veçanta shëndetësore, duke lehtësuar barrën financiare të trajtimit dhe shërbimeve mjekësore.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Formulari i aplikimit (tërhiqet në zyrat e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale);
2. Raporti mjekësor – kopje;
3. Dëshmia e diagnozës për të cilën aplikohet;
4. Dëshmia për datën e intervenimit apo trajtimit të fundit (nëse ka);
5. Faturat e shpenzimeve të mjekimit – kopje;
6. Letërnjoftimi – kopje;
7. Konfirmimi nga banka për numrin e xhirollogarisë bankare.

Kriteret prioritare për përfitim:

- Personat me sëmundje të rënda dhe me kosto të lartë të trajtimit mjekësor;
- Personat që nuk kanë përfituar mbështetje financiare nga burime të tjera;
- Personat që nuk kanë përfituar subvencione komunale gjatë dy (2) viteve të fundit;
- Personat me gjendje të rëndë socio-ekonomike;
- Përparësi kanë aplikuesit që janë nëna vetushqyese.

Mënyra e aplikimit:

Formularët për aplikim mund të tërhiqen dhe dorëzohen në: **Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** – kati i dytë, Ndërtesa e ish-objektit të Urbanizmit, Komuna e Gjakovës.

Afati i aplikimit:

Ftesa publike mbetet e hapur për **30 (tridhjetë) ditë kalendarike**, nga data **02.03.2026 deri më 31.03.2026**, deri në ora **16:00**.

Përzgjedhja e përfituesve do të bëhet nga Komisioni Vlerësues i emëruar nga Komuna e Gjakovës, në përputhje me kriteret e përcaktuara.

Lulzim GOQI

Drejtor i DSHMS-së
